



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Komisioni shtetëror për parandalimin e korrupsionit, në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " Nr. 12/2019) nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, dhe nga udhëzimi për renditjen e lëndëve për veprim të KSHPK-së në bazë të denoncimeve (nr.03-2233/1 të datës 12.02.2021), duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur në vazhdimin e tretë të seancës së 50-të, të mbajtur më 23.07.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-626/1 e dorëzuar në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga parashtruesit- /// nga Shkupi dhe /// nga Shkupi me datë 09.02.2021, në bazë të të cilit është formuar lënda me numër 12-626/1 të datës 09.02.2021, REFUZOHET.

Duke pasur parasysh se përmbajtja e denoncimit dhe detajet e dokumentacionit të bashkangjitur i referohen procedurave të përfunduara me aktvendim të plotfuqishëm kundër të cilit tashmë po vepron organ tjetër kompetent, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vlerësoi se nuk ka bazë për ndërmarrjen e masave të tjera dhe aktivitetet në kuadër të veprimit të tij në lëndën me numër 12-626 / 1 të datës 09.02.2021 në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12 -626/1 të datës 09.02.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Deri te parashtruesit e denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK -së, me arsyetim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-626/1 e datës 09.02.2021 e formuar në bazë të denoncimit nga parashtruesit /// nga Shkupi dhe /// nga Shkupi, dorëzuar në KSHPK me datë 09.02.2021.

Në denoncim janë nxjerr pohime për zbatimin jokonsistent të dispozitave nga Ligji për denacionalizim nga autoritetet për zbatimin e tij gjatë veprimit në lëndë në të cilin, sipas të theksuarës në lëndë, shkelet e drejta individuale e parashtruesve dhe personave të tjerë fizikë, në emër të të cilëve ata i drejtohen në cilësinë e trashëgimtarëve të pasurive të patundshme, për shkak të së cilës ata bëjnë thirrje për fillimin e procedurave në KSHPK dhe në institucionet e tjera.

Sipas të theksuarës në denoncim, trashëgimtarët në 2001 paraqitën kërkesë për denacionalizim në Ministrinë e Financave, pas së cilës u veprua, dhe në 2002 nga njësi kompetente rajonale e Ministrisë së

Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave i propozoi Ministrisë së Financave si kompensim që tokës bujqësore të konfiskuar t'i ndahet një parcelë në KK ///, në pronësi të Republikës së Maqedonisë. Parcela nuk ishte ndarë në periudhën deri në vitin 2015, kur njësisia rajonale e MBPEU iu drejtua përsëri Ministrisë së Financave, përkatësisht Komisionit për përcaktimin e llojit të kompensimit në procedurën e denacionalizimit në këtë ministri, duke iu referuar të njëjtës parcelë si propozim- kompensim, duke treguar se parcela 2004 është subjekt i qirasë. Sipas të theksuarës në denoncim, Komisioni për vendimmarrje sipas kërkesës për denacionalizim mori aktvendim në të cilin tre parcela të tjera kadastrale të tokës jo bujqësore u përcaktuan si një lloj kompensimi, pavarësisht se në vitin 2016 Drejtoria për Çështjet Pronësore dhe Ligjore në Strumicë me procesverbal të personit ekspert tregoi se zonat e tre parcelave janë toka jo bujqësore të papunuara, të mbipopulluara dhe të përmybytura - zona ujore që përdorshin për ndërtimin e kasolleve të gjuetisë për gjah në sezonin e gjuetisë. Parashtruesit theksojnë se në vitin 2019 lënda është për veprim në Gjykatën Administrative.

Gjatë shqyrtimit të lëndës së rastit, KSHPK i mori parasysh pohimet në lëndë dhe bëri kontroll në dokumentacionin e dorëzuar në shtojcë të denoncimit, që përmban: kopje të përgjigjes ndaj një kërkesë të vitit 2020 nga Komisioni për vendosjen mbi kërkesat e denacionalizimit me njoftim për plotfuqishmëri të procedurës së mbaruar për denacionalizim dhe njoftim të padis së ngritur në Gjykatën Administrative nga viti 2019; kopje të një teksti gazetaresk; kopjet e adresave me shkrim të pasardhësve të ministrave; kopje të dokumenteve nga procedura e denacionalizimit, përfshirë kopjet e njoftimeve për autoritetet kompetente në procedurë; kopjet e korrespondencës midis trashëgimtarëve dhe autoriteteve kompetente.

Duke pasur parasysh detajet nga denoncimi dhe nga dokumentacioni i bashkangjitur i referohen procedurave të përfunduara me aktvendim të plotfuqishëm kundër të cilit tashmë po vepron organ tjetër kompetent, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vlerësoi se nuk ka bazë për ndërmarrjen e masave të tjera dhe aktivitetet në kuadër të veprimit të tij në lëndën në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së
Punuar nga: A.R.M.
Miratoi: M.r.SH.S, Anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska